

Ekskluzive

Ekskluzive | Krisma në oborrin e restorantit në Isniq të Deçanit – plumbat dëmtojnë objektin, arrestohet dasmori



Sinjali.com

03 Gusht 2026 10:14



Të shtëna me armë zjarri janë raportuar në një aheng familjar në fshatin Isniq të Deçanit, ku plumbat kanë përfunduar në një objekt afarist, duke shkaktuar dëme materiale.

Sinjali mëson se i dyshuari është **Fatlum Batatina** rreth 28 vjeçar.

Sipas burimeve, ngjarja ka ndodhur më 1 gusht, rreth orës 13:40, në oborrin e restorantit “Grand Tropikana”, ku një person, nga një veturë e kolonës së dasmoreve, dyshohet se ka shtënë disa herë me armë zjarri dhe më pas është larguar në drejtim të Pejës.

Pas raportimit, patrulla e Policisë ka dalë në vendin e ngjarjes, ku në hyrje të oborrit janë gjetur pesë gëzhoja, ndërsa nga të shtënat është dëmtuar muri i objektit afarist “Niki”, si dhe disa tjegulla të ndërtesës.

Në vendngjarje kanë intervenuar edhe hetuesit policorë dhe njësia e krimteknikës, të cilët kanë kryer ekzaminimin dhe kanë mbledhur provat materiale.

Nga veprimet hetimore është identifikuar dhe arrestuar Fatlum Batatina, ndërsa Policia i ka sekuestruar armën me të cilën dyshohet se janë kryer të shtënat. Burimet bëjnë të ditur se arma ishte me leje valide, e vlefshme deri më 6 janar 2027, megjithatë përdorimi i saj në rrethana të tilla përbën bazë për përgjegjësi penale.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj tij është iniciuar procedurë për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”.

Pas intervistimit në prani të avokatit mbrojtës, Fatlum Batatina është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet për rastin janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

plumba

Të tjera:



Ekskluzive | Sherri për pronën përfundon me plumba në Vushtri – i dyshuari vetëdorëzoh...

Sinjalizime



U godit me gjashtë plumba: Vritet një 20-vjeçare në Iran, u shfaq pa shami gjatë...

Botë



Siriani që u gjet në malin e Vërmicës dyshohet se u vra, u qëllua në gjoks me disa plumba

Siguri



Kapen dy të rinj duke shitur marihuanë në Vushtri, u ikin policëve por arrestohen pas dis...

Siguri



Ky është Polici që e vrau vëllain me 6 plumba në Gushtericë të Poshtme

Siguri



Gjuajtje me armë zjarri në një motel në Shkabaj, Policia gjen plumba të pa shkrepur dhe gjurmë...

Siguri



Këngët me sharkia e 'nxehin' keq kosovarin, gjuan mbi 10 herë me armë brenda odës me...

Siguri



E tmerrshme/ Pakistanezi vret me 5 plumba vajzën 1-javëshe, veç pse nuk...

Botë

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera